

PKR.nr. 13/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja Suzana Çerkini, me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit V. O. nga fshati K., Komuna L., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.643/2013 të datës 16.01.2014, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 16.11.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Besa Krajku dhe të pandehurit V. O., po të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri V. O., nga i ati S. dhe nëna Sh., e vajzërisë B., i lindur me *data e lindjes...* në fshati K., Komuna L., ku edhe tani jeton, i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, punon hidroinstalues, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal *numër personal...*,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, që nga data e pavërtetuar e gjerë me datë 08.07.2013 rreth orës 19:30 pa lejen e organit kompetent ka mbajtur armë zjarri (pistoletë) te tipit EKOL TUNA me numër serik ET1110307, me te cilën armë, datën lartcekur në fshatin K. në vendin e quajtur “të qeshmja” ka shkrepur tre plumba në ajër duke shkaktuar rrezik të përgjithshëm,

- me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 49, 50, 51, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe nenit 248, 365, 366 të KPP, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Në kohëzgjatje prej **1 (një)** viti i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **2 (dy)** vjetësh nuk do të kryejë veprë të re penale, si dhe

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohen: një armë revole e tipit “Ekol Tuna” 8 mm, me nr, ET1110307, një Karikator të precizuara në vërtetimin e bashkangjitur në shkresa të lëndës, mbi marrjen e përkohshme të sendeve, Nr.20B-AH-0773, të datës 08.07.2013, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i pandehuri t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, obligohet të paguajë shumën prej nga **50 (pesëdhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të Rënda, me Aktakuzën PP.nr.643/2013 të datës 16.01.2014, ka akuzuar të pandehurin V. O., për vepër penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 të KPRK dhe Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe, njëherësh ka propozuar gjykatës që, pas administrimit të provave të propozuara në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t’a shpall fajtor dhe t’a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar në të cilin fillimisht prokurori i shtetit ka bërë precizimin e aktakuzës, duke ndryshuar kualifikimin ligjor të veprave penale, ashtu që, në vend të veprave penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 të KPRK dhe mbajtje ne pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, të pandehurin e ka akuzuar për vepër penale nga neni 375 par.1 të KPRK.

I pandehuri V. O., duke u vënë në dijeni të plotë për pasojat dhe përparësit e pranimit të fajësisë, vullnetarisht pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë të precizuar, më tutje ka shtuar se ditën kur kanë ardhur policia vullnetarisht e ka dorëzuar armën, shpreh keqardhje për veprimin që ka bërë, thekson se ka qenë i ri dhe ka gabuar, por nga ajo kohë deri më tani nuk ka kryer vepër tjetër penale, premtion se edhe në të ardhmen asnjëherë nuk do të përsëris asnjë lloj vepre penale.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, prokurori i shtetit theksoi se e mbështet pranimin e fajësisë ngase i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi nga i njëjti është bërë në përputhje me provat e bashkangjitura në aktakuzë.

Gjykata, pas mendimit të prokurorit të shtetit, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPPK, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe vullnetarisht ka pranuar fajësinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat e pranimit të fajësisë dhe se, pranimi është në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës, e aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri V. O., për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj, gjykata, pasi që konstatoi se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet e veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK dhe, pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë matjes dhe përcaktimit të dënimit ndaj të pandehurit të lartshënuar, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit, si rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, moshën e re të kryesit, sjelljen e tij korrekte në gjykatë, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur, premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit i shqiptoi dënimin me burg të cilin ia kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, të precizuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe se i njëjti, në të ardhmen nuk do të përsëris vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimi për konfiskimin e sendeve, të armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura, përkatësisht të përdorura në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 62 të KPRK lidhur me nenin 375 par. 3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 dhe 498 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.13/14, me datë 16.11.2016**

**Sekretarja juridike,
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.